

FLETËPALOSJE - INFORMACION PËR PËRDORUESIT

ALGOPET 100 mg tabletë e veshur me cipë të hollë



Për përdorim nga goja

- **Principi aktiv:** Çdo tabletë e veshur me cipë të hllë përmban 100 mg flurbiprofen.
- **Eksipientë:** Celulozë hidroksipropil, dioksid koloidal silikoni, laktozë monohidrat, celulozë mikrokristalin, kroskarmelozë natriumi, stearat magnezi, hipromelozë, dioksid titaniumi, glikol polietileni, FD & C blu nr. 2

Lexoni me kujdes te gjithë këtë fletëpalosje para se të nisni përdorimin e këtij bari, sepse përmban informacion të rëndësishëm për ju.

Mbajeni këtë fletëpalosje. Mund të keni nevojë ta lexoni sërish.

Nëse keni ndonjë pyetje të mëtejshme, konsultoni mjekun tuaj ose farmacistin.

Ky bar është përshkruar vetëm për ju, mos ua sygjeroni personave të tjerë.

Informoni mjekun tuaj që jeni duke u trajtuar më këtë bar, në rast se bëni vizitë tek mjeku ose jeni në spital.

Ndiqui rreptësisht udhëzimet në këtë fletëpalosje informative.

Mos përdorni doza më të larta ose më të ulëta, përveç se ajo që është rekomanduar për ju.

Në këtë fletëpalosje:

1 Çfarë është ALGOPET dhe përse përdoret?

2 Përpara se të përdorni ALGOPET

3 Si ta përdorni ALGOPET?

4 Cilat janë efektet e mundshme anësore ?

5 Kushtet e ruajtjes së ALGOPET

Janë përfshirë.

1. Çfarë është ALGOPET dhe përse përdoret?

ALGOPET është tabletë e veshur me cipë të hollë, ngjyrë blu, në formë ovale, e shënuar në një anë. Çdo tabletë e veshur me cipë të hollë përmban 100 mg flurbiprofen. Ajo gjendet në paketë me blistera me 15 tableta.

ALGOPET është i përfshirë në një grup të quajtur barna anti-inflamatorë jo-steroidal, që përdoren për të hequr apo lehtësuar dhimbjet e ndryshme.

ALGOPET është përdorur për trajtimin e;

- Sëmundjeve reumatizmale të karakterizuara nga pezmatimi i kyçeve/artikulacioneve (artriti reumatoid)
- Sëmundjeve degjenerative të kyçeve/artikulacioneve (osteoartrit)
- Një sëmundje reumatizmale që karakterizohet nga ngurtësimi (hardening) dhe ulja e lëvizshmërisë së nyjeve intervertebrale (ankylosing spondylitis)
- Sëmundjeve inflamatorë të indeve të buta përreth nyjeve (bursit dhe tendinit)
- Dëmtimeve të indeve të buta
- Dhimbjeve menstruale (dismenorrhea)

2. Përpara se të përdorni ALGOPET

MOS e përdorni ALGOPET në kushtet e përcaktuara më poshtë;

Nëse;

- Ju jeni të ndjeshëm (alergjik) ndaj ndonjë nga përbërësit në ALGOPET,
- Nëse ju keni pasur astmë, urtikarie ose ndonjë lloj tjetër të reaksionit alergjik pas keni marrë aspirinë apo barna të tjera anti-inflamatore jo-steroidale,
- Ju keni një dhimbje para ose pas ndërhyrjes kirurgjikale, bypass-it të arteries koronare (Coronary artery bypass),
- Ju keni insuficiencë të rëndë të mëlçisë,
- Ju keni insuficiencë të rëndë të veshkës,
- Ju keni insuficiencë të rëndë kardiake,
- Ju aktualisht keni, apo më parë keni pasur, një sëmundje të ulçerës peptike,
- Ju jeni në tremujorin e fundit (prej 6 muaj e në vazhdim) të shtatzënisë.

Ju lutemi merreni ALGOPET me kujdes në kushtet e përcaktuara më poshtë;

Nëse;

- Ju keni një sëmundje të njohur të zemrës ose enëve të gjakut (kardiovaskulare) Në një rast të tillë, mjeku juaj do t'ju përshkruajë të përdorni dozën më të ulët efektive. Edhe në qoftë se, ju nuk keni përjetuar kurrë më parë simptomat kardiovaskulare, mjeku juaj dhe ju duhet të jeni vigjilent në emergjencat e ngjarjeve të tilla (si më sipër), mjeku juaj do t'ju japë informacion lidhur me çfarë duhet të bëni në një situatë të tillë,
- Ju keni një presion të lartë të gjakut (hipertension); kur sapo keni filluar trajtimin me ALGOPET, dhe gjatë këtij trajtimi, presioni i gjakut do të monitorohet nga afër nga mjeku juaj.
- Retencion/grumbullim i lëngjeve apo edemë
- Ju keni një sëmundje specifike me insuficiencë të frymëmarrjes, edemë, zmadhim të mëlçisë për shkak të insuficiencës kardiake para-ekzistuese.
- Nëse keni pasur ndodhi të tilla si, një inflamacion, hemorragji, plagë në stomak dhe perforacion (dëmtime të membranës) në stomak, zorrëve të holla apo zorrës së trashë,
- Jeni në moshë të vjetër, keni sëmundje të enëve të gjakut në zemër, apo njëkohësisht keni marrë aspirinë, ose ulceracion, gjakrrjedhje e ndodhur në

traktin gastro-intestinal, ose keni vuajtur /aktualisht vuani nga ndonjë çrregullim gastrointestinal, si p.sh. sëmundje inflamatore,

- Ju keni insuficiencë kardiake, cirrozë të mëlçisë, sindromin nefrotik ose sëmundje të dukshme të veshkave. Nëse ju, keni çrregullim të funksionit të veshkave, mjeku juaj do t'ju japë një dozë më të ulët të flurbiprofen,
- Skuqje të lëkurës/Rash, çrregullime të membranës së mukozës, apo ndonjë shenjë tjetër të mbindjeshmërisë. Në një rast të tillë, mjeku juaj do të ndalojë trajtimin tuaj,
- Ju keni ankesa të lidhura me sytë. Në një rast të tillë, konsultohuni me një okulist.

Mos përdorni në të njëjtën kohë frenues COX-2 dhe barna të tjera që përdoren për mjekim të muskujve dhe të kyçeve.

Lidhur me përdorimin e flurbiprofen, në raste shumë rralla, madje disa me pasoja fatale, mund të ndodhë një lloj sëmundje e lëkurës e quajtur dermatit exfoliativ, gjak i përqëndruar rreth syve dhe lëkurës, inflamacion që karakterizohet nga ënjtje dhe skuqje (sindromi Stevens-Johnson) dhe reagime të rënda të lëkurës, duke përfshirë nekrozë toksike epidermike.

Lidhur me këto ndodhi, ju jeni kryesisht të rrezikuar në fillim të trajtimit tuaj, dhe në shumicën e rasteve, këto fillojnë të ndodhin në muajin e parë të trajtimit.

Nëse, ndonjë prej këtyre paralajmërimeve përputhet me gjendjen tuaj të tanishme, apo me çdo periudhë në të kaluarën, ju lutemi të konsultoheni me mjekun tuaj.

Shtatzënia

Konsultohuni me mjekun tuaj ose farmacistin tuaj para se të përdorni barin.

Mos e merrni ALGOPET, gjatë muajve të fundit të shtatzënisë (prej 6 muaj e në vazhdim). Nuk është i rekomanduar për t'u përdorur gjatë shtatzënisë, vetëm nëse, është i përshkruar nga mjeku juaj.

Nëse ju, vini re se gjatë trajtimit tuaj, jeni shtatzënë, kontaktoni menjëherë mjekun ose farmacistin.

Ushqyerja me gji

Mos e merrni ALGOPET gjatë periudhës së ushqyerjes me gji. Sepse flurbiprofen kalon në qumështin e nënës, kjo mund të shkaktojë dëme në fëmijën tuaj.

Konsultohuni me mjekun ose farmacistin para se të përdorni këtë bar.

Drejtimi dhe përdorimi i makinerive

ALGOPET mund të shkaktojë disa efekte anësore si marramendje, nervozizëm, dridhje, përgjumje. Prandaj, në qoftë se ju i keni këto simptoma, mos drejtoni makinën dhe të veproni me makineri.

Informacion i rëndësishëm në lidhje me disa përbërës të ALGOPET

Ky produkt mjekësor përmban më pak se 1 mmol (23 mg) natrium. Prandaj, si shkak i marrjes së natriumit, nuk priten efekte negative.

Ky produkt farmaceutik përmban laktozë. Nëse ju, tashmë jeni infomuar nga mjeku juaj, që ju keni një intolerancë ndaj disa sheqernave, ju lutem kontaktoni me mjekun tuaj, përpara se të merrni këtë produkt mjekësor.

Përdorimi me produkte të tjera mjekësore

Disa barna që mund të ndërveprojnë me ALGOPET:

- Frenuesit ACE, dhe bllokantë angiotensin II që përdoren për presionin e lartë të gjakut dhe probleme kardiale;
- Aspirina (qetësues dhimbjesh, hollues të gjakut);
- Antikoagulantë (barna për hollimin e gjakut);
- Substancat beta-bllokuese adrenergjik (përdoret për trajtimin e presionit të lartë të gjakut)
- Diuretikë (tablet uji)
- Kortikosteroidet (përdorur për të trajtuar alergjitë dhe mungesën e ekuilibrit hormonal)
- Zidovudine, tiklopidina dhe ciklosporinë (barna që përdoren në transplantimin e organeve)
- Litium ose frenues selektiv të ripërthithjes (reuptake) të serotoninës (barna psikiatrike)

- Methotrexate (përdoret në trajtimin e kancerit)
- Digoxin (përdoret për insufiçencen kardiake)
- Agjentët hipoglicemikë oral (barna për trajtimin e diabetit)
- Antibiotikët kuinolone / me spektër të gjerë

Në qoftë se, ju jeni duke marrë ,ose, kohët e fundit keni marrë ndonjë bar me recetë apo bar pa recetë, ju lutem informoni mjekun ose farmacistin tuaj.

3 Si ta përdorni ALGOPET?

Udhëzime për përdorimin e duhur dhe shpeshtësinë e dozës

Doza ditore e zakonshme është 150 deri 200 mg, në doza të ndara.

Kjo do të thotë se; ju duhet të merrni 1.5 apo 2 tableta në ditë. Doza mund të rritet në një maksimum prej 300 mg në ditë, në përputhje me shkallën e rëndesës së simptomave të sëmundjes suaj.

Doza e rekomanduar e ALGOPET për qetësimin e shenjave dhe simptomave të artritis reumatoid (trupi krijon pezmatim në kyçe dhe ndonjëherë në indet e tjera), ose osteoartritis (gjendjen e dëmtimit, dhimbje dhe ngurtësi jo-inflamatore (pa mahisje) në nyjet, vërejtur kryesisht tek të moshuarit) është 200 deri 300 mg në ditë në dy, tre ose katër doza të ndara.

Në simptomat e dhimbjeve menstruale, fillimisht ju duhet të merrni 100 mg (1 tabletë), e ndjekur nga 50 mg ose 100 mg në çdo 4 deri në 6 orë.

Doza maksimale e rekomanduar në aplikimet e shpeshta të barit është 100mg.

Rruga dhe mënyra e përdorimit:

Merreni tabletën tuaj pas një vakti, shoqëruar me një gotë me ujë.

Grupmosha të ndryshme :

Përdorimi në fëmijë:

Mos e përdorni barin tek fëmijët, për shkak se, siguria dhe efikasiteti i ALGOPET nuk janë vendosur.

Të moshuarit:

Duke qenë se, pacientët e moshuar janë të rrezikuar, për shkak të efekteve serioze anësore, duhet të administrohet doza më e ulët.

Kushtet e veçanta e përdorimit***Përdorimi në insuficiencën renale apo hepatike:***

Terapia afatgjatë tek pacientët ka shkaktuar dëmtime në veshka, kështu që, ALGOPET duhet të përdoret me kujdes në pacientët me pamjaftueshmëri të rëndë hepatike dhe renale.

Megjithatë, nuk rekomandohet përdorimi tek pacientët me insuficiencë të rëndë të veshkave.

Nëse keni përshtypjen se efikasiteti i ALGOPET është i fuqishëm apo i dobët, konsultohuni me mjekun ose farmacistin.

Nëse ju merrni më shumë ALGOPET se sa ju duhet:

Nëse ju keni përdorur më shumë ALGOPET se sa ju duhet, konsultohuni me një mjek ose farmacist.

Nëse ju keni përdorur më shumë ALGOPET se sa ju duhet, ndodhin kryesisht simptoma si, marramendje, të përzjera, të vjella dhe dhimbje barku. Në këtë rast duhet të t'i nënshtroheni një kujdesi simptomatik dhe mbështetës.

Nuk ka asnjë antidot specifik. Përdorimi i qymyrit aktiv duhet të jetë i dobishëm brenda 4 orëve pas marrjes ALGOPET. *Mjeku ose farmacisti juaj do t'ju ndihmojë në këtë drejtim.*

Nëse ju harroni të merrni ALGOPET:

Nëse ju harroni të merrni ndonjë dozë, merreni atë sa më shpejt që ju kujtohet. Megjithatë, në qoftë se është koha për të marrë dozën tjetër pasuese, tejkalojeni dozën e harruar dhe vazhdoni përdorimin si zakonisht.

Nëse ju nuk mbani mend nëse e keni marrë ose jo tabletën tuaj, mos merrni një dozë të dyfishtë për të zëvendësuar dozën e harruar, doza mund të jetë e tepërt për ju.

Nëse ju harroni të merrni më shumë se një dozë, ju lutem informoni mjekun tuaj.

4 Cilat janë efektet e mundshme anësore?

Ashtu si të gjitha barnat, pacientët me ndjeshmëri ndaj përbërësve të ALGOPET, mund të përjetojnë efekte anësore.

Nëse ju ndodh të pësoni ndonjë nga efektet e mëposhtëm ndërprisni trajtimin me ALGOPET dhe kontaktoni URGJENTISHT me një mjek, ose shkoni në urgjencën më të afërt spitalore:

Nëse:

- Dispnea (marrje fryme/bronkospazëm);
- Gjakrrjedhje në stomak dhe zorrë (gjakderdhje në jashtëqitje ose në të vjella);
- Zverdhje e lëkurës ose syve;
- Halucinacione (shikimi i gjërave që nuk janë, sikur keni iluzione);
- Shikim i turbullt apo i dyfishtë;
- Grumbullimi i lëngjeve në trup (të tilla si ënjtje të kyçeve të këmbëve);
- dhimbje të rënda koke, temperaturë të lartë, ndryshime në shikim.

Këto janë efekte të rënda negative. Nëse ju ndodh ndonjë nga këto simptoma, ju mund të keni nevojë për vëmendje emergjente mjekësore ose kërkohet mbikqyrje spitalore

Nëse vëreni ndonjë nga efektet anësore të mëposhtme, kontaktoni urgjentisht me një mjek, ose shkoni në urgjencën më të afërt spitalore :

- Skuqje të lëkurës/Rash (urtikarie)
- Hipotension apo hipertensioni
- Humbja e oreksit, etja e tepruar, të vjella shoqëruar me inflamacion të veshkave (nefrit intersticial)
- Insuficiencë renale

Të gjitha këto janë efekte shumë të rënda anësore. Ju mund të keni nevojë për kujdes urgjent mjekësor.

Nëse ndonjë nga këto ndodh, ju lutem tregojini mjekut tuaj:

- Dhimbje barku
- Të përzjera
- Ndryshime në oreks
- Ndryshime në shije
- Gojë e thatë, mornica/të dridhura, ethe, djersitje, palpitacion/rrahje zemre
- Dobësi, ndjenja të qënies i/e sëmurë .

Të gjitha këto janë efekte të lehta anësore të ALGOPET.

Nëse vini re ndonjë efekt anësor që nuk përmendet në këtë fletëpalosje, informoni mjekun apo farmacistin.

5 Kushtet e ruajtjes së ALGOPET

Ruajeni ALGOPET në paketë dhe mbajeni jashtë kontaktit dhe shikimit të fëmijëve dhe ne paketën e saj.

Ruajeni ALGOPET në temperaturën e dhomës, më poshtë se 25°C.

Përdoreni në përputhje me datën e skadimit.

Mos e përdorni ALGOPET pas afatit të skadencës të shënuar në paketë.

Mos e përdorni ALGOPET, në rast se, vini re se paketa është e dëmtuar apo shenja falsifikimi.

Mbajtësi i licencës:

Ilko ILAC San. ve Tic. A. s. Veysel Karani Mah. Colakoglu Sok. No: 10, 34885
Sancaktepe / İstanbul, Turkey

Vendi i prodhimit: Ilko ILAC San. ve Tic. A. s. A.Ş. 3. Organize Sanayi Bolgesi
Kuddusi Cad. 23. Sok. No: 1 Selcuklu / Konya, Turkey